



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Thirrje për pjesëmarrje

Konferencë Ndërkombëtare e Studimeve Shqiptare

Konferenca Ndërkombëtare e Studimeve Shqiptare është nismë shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Konferenca synon të çojë më tej arritjet shkencore shumëvjeçare të deritashme në këtë fushë.

Gjatë dekadave të fundit, në albanologji kanë ndodhur ndryshime sasiore e cilësore. Me rëndësinë që mori në vijimësi çështja shqiptare, roli shkencor i albanologjisë është rritur. Qendrat e albanologjisë, tradicionale e të reja, janë zhvilluar në të dyja drejtimet, in extenso e in intenso. Paraqitja e prurjeve të reja të këtyre qendrave në këtë konferencë mëton të jetë me dobi për studimet albanologjike.

Konferenca gjithashtu synon të shënojë një hap të ri në zhvillimin dhe në thellimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kërkimore, të njëjve kërkimore dhe të studiuesve.

Disiplinat orientuese të konferencës janë:

- 1. Arkeologji** (Mbishtresime të grupeve të mëdha kulturore në hapësirën protoilire - Ilirët dhe qytetërimi ilir në kontekstin ballkanik e mesdhetar - Kriza e antikitetit të vonë, krishterimi i hershëm dhe rimodelimi socio-kulturor i shoqërisë ilire);
- 2. Histori** (Vendi gjeopolitik dhe organizimi politiko-administrativ i Shqipërisë bizantine - Dualizmi kishtar e kulturor ndër Arbrit - Pushtete të huaja dhe pulsime autonomiste, shek. XII-XIV - Mes

kolonizimit venecian e invazionit osman: kriza e madhe e shek. XV - Ndryshime social-kulturore nën regjimin e sulltanëve: faktorë divergjentë e faktorë konvergjentë - *Një rilindje para Rilindjes*: fillesat e lëvizjes kombëtare, roli i arbëreshëve);

3. **Gjuhësi** (Studimet diakronike dhe sinkronike të shqipes -Varietet e shqipes - Dinamikat e zhvillimit të shqipes);
4. **Letërsi** (Histori e letërsisë shqipe - Poetika - Letërsia shqipe dhe identiteti - Autorë përfaqësues - Letërsia e sotme shqipe - Letërsia shqipe dhe letërsitë e tjera);
5. **Antropologji kulturore** (Shtresime të miteve, riteve dhe ritualeve – Koha dhe vendi i formimit të eposit – Traditat etnojuridike dhe kodet zakonore – Kulturat në kufi, dukuria ndërkulturore – Ballkanizimi i traditave gojore);
6. **Historia e artit** (Tipare të arkitekturës ushtarake, civile dhe fetare në Shqipëri - Artet e bukura në monumentet historike).

Punimet e Konferencës do të zhvillohen në Tiranë, më 25-27 nëntor 2021. Lutem studiuesit e interesuar që brenda datës 30 qershor të konfirmojnë pjesëmarrjen titullin e kumtesës dhe brenda datës 30 shtator 2021 të dërgojnë një abstrakt në shqip ose anglisht në adresat e sekretarisë teknike të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike: vitoreveli@gmail.com dhe editadedia@gmail.com.

Detaje të tjera lidhur me programin, zhvillimin e Konferencës dhe modalitetet e udhëtimit do të njoftohen në vijim.